

*Emërtimi dhe Forma ligjore*

*NIFT*

*Adresa e Selisë*

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**

**K21505001Q**

*Vorë, km. 20, Tiranë*

*Data e krijeimit*

**5 Shkurt 2002**

*Veprimtaria Kryesore*

**Prodhim BETONI**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

**VITI 2019**

*Pasqyrat Financiare janë*

*Pasqyrat Financiare janë të shprehura*

*Periudha Kontabël e Pasqyrave Financiare*

*Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare*

*Individuale*

*në Lekë Shqiptare*

*Nga 1 Janar 2019 deri 31 Dhjetor 2019*

*11 Gusht 2020*

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

## Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar.....	6
Pasqyra e Performancës dhe e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse.....	7
Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare.....	8
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto.....	9
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE.....	10
1. Informacione të përgjithshme.....	10
2. Bazat e përgatitjes.....	10
3. Aktivet monetare.....	11
4. Te drejta te arketueshme.....	11
5. Inventari.....	11
6. Aktive afatgjata financiare.....	11
7. Aktivet afatgjata materiale.....	12
8. Detyrime ndaj institucioneve te kredise.....	13
9. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit.....	13
10. Arketime ne avance per porosi.....	13
11. Të pagueshme për detyrimet tatimore.....	13
12. Detyrime afatgjata.....	14
13. Te ardhura nga veprimitarite.....	14
14. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme.....	14
15. Shpenzime të personelit.....	15
16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi.....	15
17. Shpenzime financiare.....	15
18. Tatimi mbi fitimin.....	16
19. Manaxhimi i riskut financiar.....	16
20. Ngjarje pas dates se raportimit.....	17

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**  
Për Asamblenë dhe Administratoret e shoqërisë FERRO BETON &  
CONSTRUCTION CO. SHPK

**Opinion me Rezervë**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier më datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbylli më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabёl më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në bazat për opinion me rezervë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin që mbylli më këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare te Kontabilitetit te përmirësuara, ne Shqipëri (SKK).

**Baza për Opinionin me Rezervë**

1. Siç është paraqitur në shënimin nr. 4 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019, kérkesat e arkëtueshme tregtare janë në vlerën 2,535,931 mijë Lek (2018: 2,280,658 mijë Lek). Deri më datë 31 Dhjetor 2019 shoqëria nuk ka njojur ndonjë shumë për zhvlerësimin e këtyre kérkesave për arkëtim. Nga procedurat analitike rezulton që një pjesë e konsiderueshme e tyre janë mbi 365 ditë. Gjithashtu, ne patem veshtiresi edhe ne marrjen e letrave te konfirmimit nga palet e treta. Ne nuk jemi në gjendje të sigurohem i lidhje me vleren e ketyre kérkesave dhe mundësinë e arkëtimit të plotë të tyre. Per rrjedhoje, ne nuk mund të gjykojmë mbi shumën e ndonjë zhvlerësimi të nevojshëm për tu bërë si dhe efektet që kjo do të kishte në rezultatin e vitit si edhe në llogaritë e arkëtueshme nga klientët.

2. Siç paraqitet në shënimin nr. 9 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2019, vlera e llogarive të pagueshme tregtare është 2,405,368 mijë Lek (2018: 1,870,432 mijë Lek) per të cilat ne nuk kemi mundur të fitojmë një siguri të arsyeshme për saktësinë e tyre as nëpërmjet letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të kishte nga ndonjë korrigjim i mundshëm i tyre në pasqyrat financiare në 31 Dhjetor 2019 dhe 31 Dhjetor 2018.

3. Shoqëria duhet te paraqese ne pasqyrat financiare informacione mbi palet e lidhura si dhe detaje lidhur me riskun financier ashtu sic parashikohet ne SKK 2. Megjithate, shoqëria nuk ka paraqitur asnjë informacion mbi transaksionet me palet e lidhura ne shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare si dhe ka paraqitur vetem politikat e perdonura lidhur me ekspozimin ndaj riskut financiar.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme pér auditimin e pasqyrave financiare në Shqiperi, dhe kemi përbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme pér të dhënë një bazë pér opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e Administratoreve dhe të Personave të Ngarkuar me Mbikqyrjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës pér përgatitjen e pasqyrave financiare që japid një pamje të vërtetë dhe të drejtë në përputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit, dhe pér të tilla kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme pér të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë pér shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës pér të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë pér të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, pér çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabel të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës pér mbikëqyrjen e procesit të raportimit finansiar të Shoqërisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit pér Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në térësi nuk kanë anomali materiale, pér shkak mashtimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë pér shkak të mashtimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme pér të siguruar një bazë pér opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomali materiale si rezultat i mashtimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

- rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmérinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmérinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
  - Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmérinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrjmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjera, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirëndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Sokol Toska  
Auditues Ligjor



Rr. Tish Dalia, Kompleksi Kika 2  
Kulla 2, Nr. 33  
Tirana 1060, Albania  
+355 683317751  
contact@toska.al  
L62207031A

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**  
Me 31 Dhjetor 2019

		2019	2018
	Shenime		
<b>AKTIVE</b>			
Aktivet monetare	3	2,501,203	5,002,374
Të drejta të arkëtueshme	4	2,549,413,314	2,294,161,648
Inventarët	5	224,115,487	221,828,226
<b>Aktive Afatshkurtra</b>		<b>2,776,030,004</b>	<b>2,520,992,248</b>
Aktive financiare	6	96,638,691	80,585,470
Aktive materiale	7	404,402,509	368,371,378
<b>Aktive Afatgjata</b>		<b>501,041,200</b>	<b>448,956,848</b>
<b>TOTAL AKTIVE</b>		<b>3,277,071,204</b>	<b>2,969,949,096</b>
<b>DETYSRIMET</b>			
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	8	100,039,000	99,911,155
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	9	2,405,367,707	1,870,431,776
Arketime ne avance per porosi	10	38,040,691	227,490,861
Të pagueshme për detyrimet tatimore	11	13,873,646	3,993,508
<b>Detyrimet Afatshkurtra</b>		<b>2,557,321,044</b>	<b>2,201,827,300</b>
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	12	10,745,275	25,545,275
Huamarje të tjera afatgjata	12	172,749,786	212,369,012
<b>Detyrimet Afatgjata</b>		<b>183,495,061</b>	<b>237,914,287</b>
<b>TOTAL DETYSRIME</b>		<b>2,740,816,105</b>	<b>2,439,741,587</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali I Nenshkuar		200,000,000	200,000,000
Rezerva statusore		45,696,558	45,696,558
Fitime /Humbje te mbartura		254,510,951	249,362,012
Fitime /Humbje te vtit		36,047,590	35,148,939
<b>Total fondet e veta dhe kapitali</b>		<b>536,255,099</b>	<b>530,207,509</b>
<b>TOTAL DETYSRIME DHE KAPITALI</b>		<b>3,277,071,204</b>	<b>2,969,949,096</b>



Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**PASQYRA E PERFORMANCES DHE E TË ARDHURAVE**  
**GJITHËPËRFSHIRËSE**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

	2019	2018
Shenime		
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	13 1,399,607,713	1,176,530,493
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	13 64,667,453	218,310,834
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	14 -1,135,354,935	-936,620,718
Shpenzime të personelit	15 -47,129,733	-43,347,377
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7 -63,548,321	-70,065,465
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	16 -167,179,075	-293,026,811
Të ardhura të tjera	0	0
Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare si aash	0	0
Shpenzimet financiare	17 -8,077,073	-10,404,114
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>42,986,028</b>	<b>41,376,842</b>
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	18 -6,938,438	-6,227,903
<b>Fitimi/Humbja e vtitit</b>	<b>36,047,590</b>	<b>35,148,939</b>

**Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:**

Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtarit të huaja	0	0
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	0	0
Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje	0	0
Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet	0	0
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>36,047,590</b>	<b>35,148,939</b>

*Kujtim Shtufi*

Kujtim Shtufi  
ADMINISTRATOR



*Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.*

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

2019      2018

Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme	1,488,945,043	1,477,734,171
Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve	-1,277,274,822	-1,593,640,928
Pagesa të tjera	0	0
<b>Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	<b>211,670,221</b>	<b>-115,906,757</b>
Interesi i paguar	-8,077,073	-10,404,114
Tatim mbi fitimin i paguar	-6,170,265	-5,332,421
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>197,422,883</b>	<b>-131,643,292</b>
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-99,579,453	-62,196,203
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	0	34,851,561
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	-16,053,221	0
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>-115,632,673</b>	<b>-27,344,642</b>
Hua të arkëtuara	0	189,417,723
Pagesa e huave	-54,291,381	-28,760,245
Dividendë të paguar	-30,000,000	0
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>-84,291,381</b>	<b>160,657,479</b>
Rritje(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	-2,501,172	1,669,545
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	5,002,374	3,332,831
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>2,501,203</b>	<b>5,002,374</b>

*Ku<sup>nt</sup>imi Sh<sup>t</sup>ufi*

Ku<sup>nt</sup>imi Sh<sup>t</sup>ufi  
ADMINISTRATOR



Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO**  
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	TOTAL
<b>Pozicioni finansiar më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>200,000,000</b>	<b>45,696,558</b>	<b>233,303,993</b>	<b>16,058,019</b>	<b>495,058,570</b>
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>					
Fitimi për periudhën kontabel				35,148,939	35,148,939
Kalim ne rezerva te tjerë			16,058,019	-16,058,019	0
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar				0	
Shperndarje dividendi				0	
<b>Pozicioni finansiar më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>200,000,000</b>	<b>45,696,558</b>	<b>249,362,012</b>	<b>35,148,939</b>	<b>530,207,509</b>
<b>Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:</b>					
Fitimi për periudhën kontabel				36,047,590	36,047,590
Kalim ne rezerva te tjerë			5,148,939	-5,148,939	0
<b>Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:</b>					
Emetimi i kapitalit të nënshkruar				0	
Shperndarje dividendi				-30,000,000	-30,000,000
<b>Pozicioni finansiar më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>200,000,000</b>	<b>45,696,558</b>	<b>254,510,951</b>	<b>36,047,590</b>	<b>536,255,099</b>

*Kujtim Shtufi*

Kujtim Shtufi  
ADMINISTRATOR



Pasqyrat Financiare lexohen se bashku me shenimet shpjeguese.

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

## SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

### 1. Informacione të përgjithshme

FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK është një njesi, e themeluar dhe regjistruar, me numër unik K21505001Q dhe organizohet në bazë të ligjit për shoqëritë tregtare në Shqipëri.

Objekt kryesor i aktivitetit është prodhimi i betonit.

Gjatë vitit 2019 njesia ka pasur mesatarisht 89 të punësuar. Shumën e pagave që u jepet për periudhën raportuese anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse, për shkak të përgjejësive të tyre eshte 2.640 mijë leke, ndersa tarifat gjithsej për periudhën raportuese, të kërkua nga audituesit ligjore lidhur me auditimin ligjor të ketyre pasqyrave financiare vjetore eshte 800 mijë leke.

### 2. Bazat e përgatitjes

Deklarimet financiare te bashkangjitura te shoqerise FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK jane pergatitur ne baze te rregjistimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit janë paraqitur ne formatin e kerkuar ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne fuqi.

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara si dhe mbi supozimin e biznesit ne vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do te vazhdojë ekzistencën e aktivitetit te saj për një të ardhme të parashikuar.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK te permiresuara, kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne një shkalle te larte ose komplekse te gjykitit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese nijhen ne te njejtën periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate një periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, rregistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimt.

Mbajta e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare dhe është monedha funksionale e Shoqërisë. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Ndryshimet janë kryer për të paraqitur më mirë natyrën e biznesit të Shoqëris. Ato aplikohen retrospektivisht.

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

### 3. Aktivet monetare

Gjendja e mjeteve monetare ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon.

	2019	2018
Llogari njedhese ne banke	1,462,464	29,355
Mjeten monetare ne arkë	1,038,739	4,973,020
<b>TOTAL</b>	<b>2,501,203</b>	<b>5,002,375</b>

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

### 4. Te drejta te arketueshme

Gjendja e kerkesave per arketim ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon.

	2019	2018
Kliente per shitje	2,535,930,614	2,280,658,048
Huadhenie afatshkurtra	13,482,700	13,503,600
<b>TOTAL</b>	<b>2,549,413,314</b>	<b>2,294,161,648</b>

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

### 5. Inventari

Gjendja e inventarit ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon. Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

	2019	2018
Lende te para	15,095,877	12,188,157
Materiale te tjera	715,368	713,576
Mallra per shitje	0	2,047,438
Parapagime per blerje	39,937,854	67,440,715
AACj te mbajtura per shitje	168,366,388	139,438,340
<b>TOTAL</b>	<b>224,115,487</b>	<b>221,828,226</b>

### 6. Aktive afatgjata financiare

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqiten si vijon:

	2019	2018
Huadhenie afatgjate	96,638,691	80,585,470
<b>TOTAL</b>	<b>96,638,691</b>	<b>80,585,470</b>

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

## 7. Aktivet afatgjata materiale

Gjendja e aktiveve afatgjata ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon:

### Aktivet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2019
1	Toka		57,951,080	39,680,000		97,631,080
2	Ndertime		31,820,010			31,820,010
3	Makineri,paisje		685,721,148	58,082,975		743,804,123
4	Zyre		10,391,208	1,816,477		12,207,685
	<b>TOTALI</b>		<b>785,883,446</b>	<b>99,579,452</b>	<b>0</b>	<b>885,462,898</b>

### Amortizimi A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2019
1	Toka		0	0	0	0
2	Ndertime		9,413,805	1,120,310		10,534,115
3	Makineri,paisje,vegla		403,762,834	60,993,957		464,756,791
4	Zyre		4,335,429	1,434,054		5,769,483
	<b>TOTALI</b>		<b>417,512,068</b>	<b>63,548,321</b>	<b>0</b>	<b>481,060,389</b>

### Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2019

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje 1/1/2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje 12/31/2019
1	Toka		57,951,080	39,680,000	0	97,631,080
2	Ndertime		22,406,205	0	1,120,310	21,285,895
3	Makineri,paisje,vegla		281,958,314	58,082,975	60,993,957	279,047,332
4	Zyre		6,055,779	1,816,477	1,434,054	6,438,202
	<b>TOTALI</b>		<b>368,371,378</b>	<b>99,579,452</b>	<b>63,548,321</b>	<b>404,402,509</b>

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zeri të aktiveve afatgjata materiale apo e permiresimit te aktivit njihet në vlerën kontabël të atij zeri nese është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitme të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Toka	-	Nuk amortizohet
Ndertime	Vlera e mbetur	5%
Makineri, Pajisje, Zyre, etj	Vlera e mbetur	20%

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**8. Detyrime ndaj institucioneve te kredise**

Gjendja e detyrime ne daten 31 Dhjetor 2019 perfaqeson linja kreditimi overdraft ne banke tregtare si dhe detyrime afatgjata qe maturohen gjate periudhes 2020.

	2019	2018
Overdraft bankar	60,885,000	61,710,000
Overdraft bankar	14,612,400	14,810,400
Overdraft bankar	9,741,600	9,873,600
Pjesa afatshkurter e huave bankare	<u>14,800,000</u>	<u>13,517,155</u>
<b>TOTAL</b>	<b><u>100,039,000</u></b>	<b><u>99,911,155</u></b>

**9. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit**

Gjendja e furnitoreve ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon:

	2019	2018
Detyrime ndaj furnitoreve	2,405,367,707	1,870,431,776
<b>TOTAL</b>	<b><u>2,405,367,707</u></b>	<b><u>1,870,431,776</u></b>

**10. Arketime ne avance per porosi**

Gjendja e parapagimeve te arketuara ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon.

	2019	2018
Arketime ne Avance per porosi	38,040,691	227,490,861
<b>TOTAL</b>	<b><u>38,040,691</u></b>	<b><u>227,490,861</u></b>

**11. Të pagueshme për detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqiten si vijon.

	2019	2018
Detyrim per sigurimet shoqerore	995,543	870,058
Tatim mbi te ardhurat personale	129,887	107,922
Tatim fitimi	1,676,019	907,846
Tvsh e pagueshme	11,072,197	2,107,682
<b>TOTAL</b>	<b><u>13,873,646</u></b>	<b><u>3,993,508</u></b>

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**12. Detyrime afatgjata**

Gjendja e detyrime ne daten 31 Dhjetor 2019 paraqitet si vijon.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Huamarrje bankare afatgjate	10,745,275	25,545,275
Huamarrje afatgjata nga te trete jobankare	172,749,786	212,369,012
<b>TOTAL</b>	<b>183,495,061</b>	<b>237,914,287</b>

**13. Te ardhura nga veprimtarite**

Paraqiten shitjet neto per periudhen qe raportohet.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Shitje Produkt i gatshem (beton)	1,282,143,018	1,032,732,103
Shitje materiale furnitura	76,146,338	13,967,757
Te ardhura te tjera	41,318,358	129,830,633
<b>Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit</b>	<b>1,399,607,714</b>	<b>1,176,530,493</b>
Te tjera nga shitje aagi	0	34,868,281
Penalitetë dhe gjoba te arketuara	0	5,946,189
Te ndryshme	64,667,453	177,496,364
<b>Të ardhura të tjera të shfrytëzimit</b>	<b>64,667,453</b>	<b>218,310,834</b>
<b>TOTAL TE ARDHURA</b>	<b>1,464,275,166</b>	<b>1,394,841,327</b>

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe te ardhura nga veprimtari te tjera jooperative.

**14. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Paraqiten shpenzimet per materiale e sherbime si dhe KMSH per periudhen qe raportohet.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Blerje materiale te para	1,075,616,700	866,554,436
Te tjera materiale dhe sherbime	59,738,235	70,066,282
<b>TOTAL</b>	<b>1,135,354,935</b>	<b>936,620,718</b>

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**15. Shpenzime të personelit**

Paraqiten kostot e punes per periudhen qe raportohet.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Shpenzime paga punetoret	40,443,431	37,266,793
Shpenzime sig.shoqerore	6,686,302	6,080,584
<b>TOTAL</b>	<b>47,129,733</b>	<b>43,347,377</b>

**16. Shpenzime të tjera shfrytëzimi**

Paraqiten shpenzimet e tjera operacionale per periudhen qe raportohet.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
KOSTO AQT MBAJTUR PER SHITJE	45,157,968	173,999,759
PJESE KEMBIMI PER MAKINERIA	25,763,955	21,528,771
Humbje nga kursi i kembimit	55,605,187	19,523,225
REKLAME DHE PUBLICITET	11,028,227	13,550,900
GOMA KAMIONI	5,903,313	10,486,596
RIPARIME TE NDRYSHME	4,515,322	1,793,325
Gjoba dhe demshperblime	3,270,224	142,509
TAKSA DHE KOLAUDIME MJETET	3,147,655	2,372,278
Sigurime	1,832,002	1,589,437
VAJRA GRASO DHE LUBRIFIKANTE TE NDRYSHEM	1,814,780	3,163,880
Transferime, udhetim, dieta	1,740,349	2,120,852
Shpz.postare e telekom.	1,562,603	1,463,044
Shpenzime ADMINISTRIM PRONA	1,252,729	0
Sherbime dhe ruajtje parkimi	1,236,277	1,049,278
Taksa dhe tarifa vendore	1,023,178	541,834
Shpenzime te tjera	713,222	393,678
Noterizime dhe raporte vleresimi	598,059	446,488
KONSULENCE FINANCIARE	500,000	500,000
KOMISIONE BANKARE	327,022	520,875
Tatime te tjera	187,004	128,689
SHERBIME PERMBARIMORE DHE TE TJERA	0	1,678,589
Vlera kont. e AQ te shitura	0	34,851,562
SPONSORIZIME TE KRYERA	0	1,181,240
<b>TOTAL</b>	<b>167,179,076</b>	<b>293,026,811</b>

**17. Shpenzime financiare**

Paraqiten shpenzimet financiare per periudhen qe raportohet te cilat perfaqesojne ne teresi shpenzime per interesa ndaj huave bankare.

	<b>2019</b>	<b>2018</b>
Interesa hua bankare	8,077,073	10,360,091
Interesa Leasing	0	44,023
<b>TOTAL</b>	<b>8,077,073</b>	<b>10,404,114</b>

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

**18. Tatimi mbi fitimin**

Paraqiten llogaritjet e tatimit mbi fitimin per periudhen qe raportohet.

	2019	2018
Fitimi para tatimit	42,986,028	41,376,842
Sponsorizime tej normave	0	0
Gjoba dhe demshperblime	3,270,224	142,509
<b>Rezultati per tu tatuar</b>	<b>46,256,252</b>	<b>41,519,352</b>
<b>Tatim mbi fitimin sipas shkalles tatimore</b>	<b>6,938,438</b>	<b>6,227,903</b>

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatushem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

**19. Manaxhimi i riskut financiar**

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua, llogari të arkëtueshme dhe mjete monetare që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e eksposuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit dhe te monedhes. Drejtimi i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut është rishku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: rishku i normës së interesit, rishku i kursit të këmbimit, rishku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si rishku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiare të prekur nga rishku i tregut përfshijnë huatë dhe kreditë.

Risku i kreditit është rishku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e eksposuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktivitetave operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktivitetave të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i likuiditetit është rishku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është rishku i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkjesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkuruese. Shoqëria manaxhon rishkun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të

**FERRO BETON & CONSTRUCTION CO. SHPK**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019**  
(Të gjitha shumat janë paraqitur në Lek)

vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhe profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

Shoqëria eshte e eksposuar ndaj riskut te monedhes pasi ajo ndërmerr transaksione në monedhë të huaj dhe si pasojë eksposohet ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve.

**20. Ngjarje pas dates se raportimit**

Ne fund te vitit 2019 doLEN per here te pare lajmet ne lidhje me epidemine COVID-19 (Coronavirus SARS-COV 2). Situata ne fund te vitit ishte se nje numer i kufizuar i rasteve te nje virusi te panjohur ishin raportuar ne Organizata Boterore e Shendetesise. Ne muajt e pare te vitit 2020 virusi ishte perhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ ka fituar nje impuls. Drejtimi e konsideron qe informacioni te jete nje ngjarje jo rregulluese pas dates se raportimit. Ndersa kjo eshte ende nje situate ne zhvillim ne kohen e leshimit te ketyre pasqyrave financiare, deri me tani nuk ka pasur ndonje ndikim te dukshem ne veprimtarite e shoqerise, megjithate, efektet e ardhshme nuk mund te parashikohen. Drejtimi do te vazhdoje te monitoroje ndikimin e mundshem dhe do te ndermarre te gjithe hapat e mundshem per te zbutur cdo efekt.

Nuk ka ndonje ngjarje tjeter pas dates 31 Dhjetor 2019 e cila kerkon ndonje paraqitje apo irregullim ne pasqyrat financiare.

*Kujtim Shtufi*  
Kujtim Shtufi  
ADMINISTRATOR

*M. Shtufi*

